



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4039
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 09/10.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 65

Datë: 01.10.2025.

“Për marrjen e masave për veprim ligjor në lidhje me dëmtimin e gjelbërimit publik”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Ilir Elezi
10.10.2025



4039/17/10/25
17/10/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.916/1 prot.

Peshkopi, më 17.10.2025

Lënda: Për vendimin nr.65, datë 01.10.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR
BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.65, datë 01.10.2025 “Për marrjen e masave për veprim ligjor në lidhje me dëmtimin e gjelbërimit publik”, konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi nuk bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter normativ, ndaj për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 65 Datë 01/10/2025

“Për marrjen e masave për veprim ligjor në lidhje me dëmtimin e gjelbërimit publik”.

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neneve 53, 54 dhe 55 , si dhe në përputhje me rregulloren e brendshme të Këshillit Bashkiak Dibër, mbështetur në informacionet dhe shqetësimet publike të dala në lidhje me prerjen e një peme të llojit “pishë” në shëtitoren e qytetit të Peshkopisë, për të cilën dyshohet përfshirja e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **01.10.2025** me 20 vota pro 0 kundër 2 apstenim :

VENDOSI:

1. Të shprehë shqetësimin mbi veprimin e prerjes së pishës në një nga zonat më të frekuentuara të qytetit dhe rëndësinë që ka mbrojtja e hapësirave të gjelbra për cilësinë e jetës së qytetarëve.
2. T'i kërkojë zyrtarisht Bashkisë Dibër të nisë një hetim të brendshëm administrativ për verifikimin e plotë të veprimit, për të sqaruar nëse veprimi është kryer nga struktura të bashkisë dhe me urdhër ose jo të ligjshëm.
3. Të kërkojë që, bazuar në rezultatet e verifikimit:
 - Të merren masa administrative apo disiplinore nëse konfirmohet se është vepruar në kundërshtim me ligjin.
 - Të ndërmerren veprime për kompensim mjedisor, përfshirë ripyllëzim të menjëhershëm të zonës së dëmtuar.
4. Bashkia Dibër të informojë me shkrim Këshillin Bashkiak brenda nje afati te arsyeshëm kohor mbi:
 - Ecurinë e verifikimit.
 - Rezultatet dhe përgjegjësitë e identifikuara.
 - Masat e ndërmarra.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
6. Vendimi u shpall më datë **01.10.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA

